

Ylber RAMAJ

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

FUQIZIMI I STRUKTURËS INSPEKTUESE PËR ARKIVAT GJATË VITEVE 2017-2020

***Përmbledhje:** Në këtë punim paraqes një përmbledhje të ndryshimit rrënjësor që ka pësuar struktura përgjegjëse për inspektim në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave gjatë viteve 2017-2020.*

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave u kthye në një inspektorat shtetëror për ta inspektuar punën me dokumente në sekretari - arkivat e institucioneve të administratës shtetërore, në nivel qendror dhe vendor.

Veprimtaria e çdo institucioni shtetëror pasqyrohet te dokumentet që ai krijon, ruan dhe administron.

Shërbimi arkivor në institucionet shtetërore të vendit tonë gjatë 30 vjetëve të fundit ka pësuar deformime të shumta për sa i përket mënyrës së përpilimit të akteve zyrtare, evidencimit, përpunimit tekniko-shkencor, ruajtjes dhe shërbimit të dokumenteve.

Në vitin 2017 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave u bë zyrtarisht inspektorat shtetëror, me strukturën e saj përgjegjëse për inspektimin, e cila do ta inspektojë punën me dokumente në të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë.

Shëndërimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave në një inspektorat të mirëfilltë për punën me dokumente e ka fuqizuar atë në aspekt të mbrojtjes dhe zbatimit të ligjit nr. 9154, dt. 06.11.2003, "Për arkivat", por edhe në raport me vlerësimin e punës arkivore nga ana e institucioneve shtetërore, të cilat ndër vite kishin neglizhuar urdhrat dhe udhëzimet e saj.

Aktualisht Drejtorinë e Inspektimit dhe Trajnimit e presin sfida të reja në veprimtarinë e saj inspektuese.

Gjatë viteve 2017-2020 Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave ndërmori disa nisma të rëndësishme lidhur me përmirësimin e proceseve të punës së strukturave të saj dhe mënyrës së organizimit dhe funksionimit të tyre. Një prej strukturave kryesore të DPA-së që pësoi ndryshime në mënyrën e organizimit dhe funksionimit ishte Drejtoria e Inspektimit dhe Trajnimit.

Në fillim të vitit 2017 filloi ndryshimi i mënyrës së veprimtarisë inspektuese të Drejtorisë së Inspektimit në sekretari - arkivat e institucioneve shtetërore. Nisma për ndryshimin e veprimtarisë inspektuese përkon me hartimin e projektregullores "Për procedurat e inspektimit mbi zbatimin e

njësuar të legjislacionit arkivor në rrjetin arkivor të Republikës së Shqipërisë”. Hartimi i kësaj rregulloreje nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe miratimi i saj nga Këshilli i Lartë i Arkivave ishte i nevojshëm dhe i domosdoshëm, sepse nevojitej një qasje e re në procesin inspektues, si dhe dokumentimi i të gjitha kontrolleve që kryen kjo drejtori në institucionet shtetërore. Mirëpo, edhe pse kjo rregullore ishte hartuar në përputhje me ligjin në fuqi për inspektimet, nuk përmbushte ligjërisht ndëshkueshmërinë e autoriteteve dhe personave përgjegjës të cilët ishin në shkëlqje të ligjit “Për arkivat” dhe norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Situata në të cilën ndodhej rrjeti arkivor në vend për shkak të neglizhencës ndër vite të punës arkivore dhe moszbatimit të ligjit “Për arkivat” nga institucionet fondkrijuese kishte krijuar një prapambetje të theksuar në përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve dhe mosdorëzimin e atyre me RHK, pranë arkivave shtetërore përkatëse. Përmirësimi i kësaj situatë të akumuluar prej vitesh kërkonte medoemos rishikimin e procesit inspektues të DPA-së. Zbatimi i nenit 92 për kundërvajtjet administrative ishte një ndër mënyrat për ta ndryshuar gjendjen arkivore në vend, krahas dhënies së asistencës dhe trajnimit të vazhdueshëm të arkivistëve dhe punonjësve të sekretari-arkivit të institucioneve shtetërore, qendrore dhe vendore.

Njëkohësisht, marrja e masave ndëshkuese kundrejt autoriteteve dhe personave përgjegjës do të ndikonte edhe në rritjen dhe fuqizimin e rolit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, si autoriteti më i lartë i Rrjetit Arkivor në Republikën e Shqipërisë. Neni 15 i Ligjit nr. 9154, dt. 06.11.2003 “Për arkivat” e përcakton qartë se DPA harton normën tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në RSH, si dhe kontrollon zbatimin e njësuar të saj nga të gjitha organet shtetërore e joshtetërore në vend.¹ Gjithashtu, në nenin 92 të këtij ligji përcaktohen “Kundërvajtjet administrative”, si dhe masat ndëshkuese ndaj atyre që nuk zbatojnë ligjin dhe normat për punën arkivore.² Për vënien në zbatim të nenit 15 dhe 92 të ligjit nevojitej nxjerrja e një akti nënligjor që ta përcaktonte DPA-në si inspektorat shtetëror për punën arkivore. Kështu, me Vendim të Këshillit të Ministrave u miratua rregullorja “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”³, ku në nenin 5 të kësaj rregulloreje përcaktohet struktura përgjegjëse për inspektimin, si dhe funksionimi i saj bazuar në legjislacionin në fuqi për inspektimet. Me miratimin e kësaj rregulloreje nga Këshilli i Ministrave, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave shndërrohet ligjërisht në inspektorat shtetëror për punën arkivore.

¹ Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, *Dispozita ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë*, (Tiranë, 2007), f. 11.

² Po aty f. 39.

³ VKM 360, dt. 26. 04. 2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”.

Menjëherë pas këtij vendimi, DPA nisi bashkëpunimin me Inspektoratin Qendror, për t'u bërë pjesë e trupave inspektuese në RSh. Në korrik të vitit 2017, në ambientet e Inspektoratit Qendror, në një konferencë të përbashkët mes dy titullarëve, drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave dhe kryeinspektorit, u bë prezantimi i trupës inspektuese të DPA-së. Nga ky çast, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave regjistrohet zyrtarisht si inspektorati më i ri në Republikën e Shqipërisë.⁴

Nga qershori i vitit 2017 DPA filloi të kryente inspektime në institucione me dokumente të përshtatura sipas modeleve të përcaktuara nga Inspektorati Qendror, por jo online. Kjo procedurë inspektimi me formate të përshtatura zgjati rreth tre muaj, nga qershori deri në gusht, pa kaluar në sistemin online dhe me dokumente standarde, siç përcaktohej në ligj dhe aktet nënligjore në fuqi për inspektimet.⁵

Kryerja e inspektimeve online ishte një risi e re për trupën inspektuese të DPA-së si dhe një sfidë për ta përballuar me sukses. Për arritjen e këtij qëllimi gjatë periudhës shtator-dhjetor të vitit 2017 u bë e mundur përshtatja e dokumenteve standarde me (check-list, procesverbal dhe vendim përfundimtar) sipas formateve standarde, trajnimi i trupës inspektuese, si dhe implementimi i dokumenteve në sistemin unik “e-inspektimi”, nga Inspektorati Qendror. Prej janarit të vitit 2018 trupa inspektuese e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave kryen të gjitha inspektimet online. Aktualisht trupa inspektuese ka filluar kryerjen e inspektimeve me tabletë sipas arritjeve më të fundit teknologjike në fushën inspektuese, duke mundur mundësuar nënshkrimin e akteve të inspektimit në formë elektronike etj.

Me riorganizimin e ri të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave ndryshoi edhe mënyra e organizimit të trupës inspektuese, duke shtuar numrin e inspektorëve. Si fillim, trupa inspektuese e DPA-së përbëhej nga 15 punonjës, 3 inspektorë dhe 12 titullarë të Arkivave Shtetërore Vendore, më pas filloi të shtohet numri i inspektorëve. Aktualisht kjo trupë inspektuese përbëhet nga 19 inspektorë, të cilët veprojnë në 12 qarqe të vendit.⁶

Prej rreth tre vjetësh trupa inspektuese e DPA-së ka kryer mbi 400 inspektime online në institucione të ndryshme të vendit, ku janë marrë disa masa administrative me “paralajmërim”, si dhe janë vendosur dënime administrative me “gjobë” ndaj personave përgjegjës kur janë konstatuar shkelje. Gjatë inspektimeve në institucione shtetërore qendrore e vendore janë vërejtur problematika të ndryshme, që nga mënyra e përpilimit të akteve zyrtare, evidencimit, përpunimit, kushteve të ruajtjes dhe shërbimit të dokumenteve, për të cilat janë lënë detyra dhe rekomandime për

⁴ Korrespondencë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me Inspektoratin Qendror.

⁵ Ligji nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

⁶ Urdhër nr. 18, dt. 03. 02. 2020 i kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”.

përmirësimin e tyre.⁷ Për ta kapërcyer prapambetjen e krijuar në përpunimin dhe dorëzimin e dokumenteve, si dhe për ta përmirësuar shërbimin arkivor në institucione, përveç kryerjes së inspektimeve, DPA ka organizuar edhe seminare trajnuese me synim ngritjen profesionale të arkivistëve dhe të punonjësve të rrjetit arkivor në vend.

Shndërrimi i DPA-së në inspektorat shtetëror ka ndikuar ndjeshëm në përmirësimin e shërbimit arkivor në vend. Shumë institucione shtetërore kanë filluar të dorëzojnë dokumente për herë të parë, duke pasuruar arkivat me dokumente dhe fondkrijues të rinj.

Me përmirësimin e procesit inspektues, si dhe fuqizimin e trupës inspektuese, DPA synon ta rikuperojë prapambetjen e akumuluar ndër vite në përpunimin dhe dorëzimin e dokumenteve me RHK, nga institucionet fondkrijuese të administratës shtetërore.

Bibliografi:

Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave, *Dispozita ligjore për arkivat në Republikën e Shqipërisë*, Tiranë: 2007

Korrespondencë midis Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave me Inspektoratin Qendror, Ligji nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

Raporti i Drejtorisë së Inspektimit për vitin 2018-2019

Urdhër nr. 18, dt. 03.02.2020, i kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”

VKM 360, dt. 26.04.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave”

⁷ Raporti i Drejtorisë së Inspektimit për vitin 2018-2019.